



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 126/2 Prot.

Tiranë, më 18.02.2015

VENDIM

Nr. 18, datë 18/02/2015

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/Z. , ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr.126/1 Prot., datë 05.02.2015, ndaj autoritetit publik/Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, me objekt “Refuzim për dhënie informacioni” sipas së cilës pretendon se është cënuar në të drejtën e tij për informim. Ankesa është paraqitur brenda afatit ligjor, në përputhje me nenin 24/1/2/b të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se, Z. në datë 14.01.2015 ka paraqitur pranë autoritetit publik/ Universitetit “Ismail Qemali”, kërkesën për informacion. Nëpërmjet saj, kërkuesi ka kërkuar ti vihen në dispozicion kopje të dokumenteve zyrtare, konkretisht:

1. Listë pagesa e muajit Nëntor- Dhjetor e vitit 2014 e juristit ;
2. Listë pagesa e muajit Nëntor- Dhjetor e vitit 2014 e juristes ;
3. Fotokopje e faqes së librit të protokollit të datës 24.10.2014, ku është regjistruar shkresa e përfaqësimit lëshuar nga universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, dhe ku legjitimohen juristët për të përfaqësuar këtë institucion në Gjykatën Administrative, Vlorë.

Në përgjigjen e dhënë Universiteti ka argumentuar se informacioni i kërkuar përmban të dhëna personale në referim të përcaktimeve të nenit 3/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar si dhe i nënshtrohet kufizimeve të përcaktuara në nenin 17/1/a të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Pas shqyrtimit të legjislacionit rezulton se, dokumentacioni i kërkuar nga ankuesi, *listë pagesa e muajit Nëntor- Dhjetor e vitit 2014 e juristit* dhe *listë pagesa e muajit Nëntor-*

Dhjetor e vitit 2014 e juristes , nuk përfshihet në kategorinë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë.

Në përputhje me nenin 7/1/d të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, dispozitë në të cilën ankuesi mbështet ankesën e tij parashikohet bërja publike e informacionit pa kërkesë *vetëm për pagën e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë dhe strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë.*

Sa i përket kërkesës tjetër për marrjen e fotokopjes së faqes së librit të protokollit të datës 24.10.2014, Universiteti në përgjigjen e kthyer për ankuesin ka refuzuar dhënien e tij me argumentimin se kjo faqe e librit të protokollit përmban veprimtarinë dhe korrespondencën hyrëse dhe dalëse të institucionit, ndër të tjera dhe informacione personale dhe konfidenciale.

Në këtë rast, Komisioneri çmon se faqja e librit të protokollit nuk mund të vendoset në dispozicion të plotë, por duke anonimizuar të dhënat konfidenciale.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se ankesa është pjesërisht e bazuar në ligj.

### **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në shkronjat b), c) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”,

### **V E N D O S A:**

1. Pranimin e pjesshëm të ankesës nr. 126/1 Prot., datë 05.02.2015 të Z. kundër Autoritetit Publik/Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë.
2. Urdhërimin e Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë për të pajisur Z. me fotokopjen e faqes së librit të protokollit të datës 24.10.2014, duke anonimizuar të dhënat konfidenciale, brenda datës 27.02.2015.
3. Rrëzimin e ankesës së Z , për tu pajisur me dokumentacionin, listë pagesa e muajit Nëntor- Dhjetor e vitit 2014 e juristit .
4. Rrëzimin e ankesës së Z. , për tu pajisur me dokumentacionin, listë pagesa e muajit Nëntor- Dhjetor e vitit 2014 e juristes .

Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative kompetente, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Ky vendim u dha sot në datë 18.02.2015

